

## **AGJENCIONII NACIONAL I PAGESAVE**

### **1. Përmbledhje**

Ky dokument fokusohet në situatën aktuale në Shtetet e reja Anëtare (SHRA) dhe në vendet candidate në ndërlidhje me praktikën, përvojat dhe aspektet administrative / organizative të Agjencionit Nacional të Pagesave (ANP). Për këto vende, ANP –të janë themeluar duke përcjellur modelet e BE –së me qëllim të lehtësimit të implementimit të programeve të reformuara politike bujqësore dhe me pagesën e fondeve mbrenda Programit SAPARD. Pas çasjes në BE, implementimi i pamvarur i politikës Bujqësore është zëvendësuar nga Politika e Përbashkët Bujqësore (PPB). Situata në SHRA përpara se ti bashkohen BE –së ka qenë e ngjashme me situatën e përgjithëshme në Sektorin Agro – Rural në Kosovë.

### **2. Fondet dhe Nismat e Politikës së Përbashkët Bujqësore**

Mbrenda fushës së PPB –së, subvencioni financiar është I dhënë nga Fondi i Garantuar i Bujqësisë Evropiane (EAGF) për periudhën aktuale programuese (2007-13), dhe nga Fondi Bujqësorë Evropian për Zhvillim Rural (EAFRD) dhe Fondi Evropian për Peshkatari (EFF). PPB bazohet në tri nisma:

- Tregjet e përbashkëta për produktet bujqësore të ngritura në qmimet e përbashkëta;
- Përparësitë për produktet bujqësore të BE –së, ndaj konkurrencës së jashtme; dhe
- Solidariteti Financiarë – financimi nga fondet e përbashkëta për të cilat të gjithë paguajnë taksa.

### **3. Çka është një Agjencion i Pagesave?**

Agjencionet e Pagesave janë autoritetet dhe Trupat e Shteteve Anëtare roli i të cilave është që të ofrojnë garancione të mjaftueshme që:

- Pranueshmërinë e kërkesave dhe pajtimin me Rregullat e Komuniteteve kontrollohen përpara se të autorizohen pagesat;
- Pagesat të cilat efektohen janë korrekte dhe të regjistruara në tërësi në Llogaritë; dhe
- Dokumentacioni Relevant dorëzohet mbrenda afatit kohorë dhe në mënyrën e përshkruar në Rregullat e Komunitetit.

Secili Vend Anëtarë duhet që të dërgojë te Komisioni Evropian (KE):

- Detalet e autoriteteve dhe të trupave të akredituara për kryerjen e pagesave;
- Aty ku më shumë se një Agjencion është i akredituar, detalet e autoritetit ose trupit përgjegjës për mbledhjen e informative që duhet të furnizohen te Komisioni dhe për Promovimin e aplikacionit të harmonizuar të Rregullave të Komunitetit (Të ashtëquajturat Agjencionet Ko-ordinuese);
- Emrat, statusin dhe aktet e akreditimit të agjencioneve të pagesave; dhe
- Detalet e kushteve administrative, të llogarimbajtjes dhe të auditimeve të brendshme për pagesa të krijuara mbrenda kornizës së PPB –së për të Implementuar Rregullat e Komunitetit. 1

Themelimi dhe Funkionimi i ANP është i rregulluar sipas kërkesës së legjislacionit të BE –së (p.sh. Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 1258/1999), dhe Legjislacionin e Shteteve Anëtare. Secili Vend është i pamvarur sa i përket themelimit të Agjencionit Nacional të Pagesave. Ose e bëjnë këtë duke u bazuar në legjislacionin Primarë (Ligje) ose legjislacion sekondarë (Udhëzime Administrative, Rregullore, etj). Zakonisht, ato themelohen nga një ligj special siç është ligji për Themelimin e Agjencionit Nacional për Pagesa, ose siç është rasti në Shqipëri që kanë themeluar një Agjencion për Pagesa nga Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

<sup>1</sup> Sqarimi i procedurave të Llogarive -

[http://ec.europa.eu/agriculture/publi/fact/clear/clear\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/agriculture/publi/fact/clear/clear_en.pdf) , vizituar për herë të fundit me 12.06.2008.

<sup>2</sup> [http://ec.europa.eu/enlargement/enlargement\\_process/accession\\_process/hoë\\_does\\_a\\_country\\_join\\_the\\_eu/negotiations\\_croatia\\_turkey/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/enlargement_process/accession_process/hoë_does_a_country_join_the_eu/negotiations_croatia_turkey/index_en.htm) , vizituar për herë të fundit me 29.06.2008.

<sup>3</sup> *Sine qua non* or *condicio sine qua non* (plural *sine quibus non*) ka qenë një term Latin Origjinal për "(Një kusht) pa të cilin nuk mund që të jetë" ose "mirëpo për ..." ose "pa të cilin (nuk ka) asgjë". I referohet një veprimi të domosdoshëm dhe të duhur, ose të një përmbajtje.

<sup>4</sup> [http://ëëë.arsktrp.gov.si/fileadmin/arsktrp.gov.si/pageuploads/Aktualno/Aktualno/2008/Zlozenka\\_ang\\_2008\\_Internet.pdf](http://ëëë.arsktrp.gov.si/fileadmin/arsktrp.gov.si/pageuploads/Aktualno/Aktualno/2008/Zlozenka_ang_2008_Internet.pdf) vizituar për herë të fundit me 08.07.2008.

<sup>5</sup> ibid

<sup>6</sup> [http://ëëë.mkgp.gov.si/en/bodies\\_of\\_the\\_ministry/paying\\_agency/](http://ëëë.mkgp.gov.si/en/bodies_of_the_ministry/paying_agency/) / vizituar për herë të fundit me 07.07.2008.

<sup>7</sup> Në Sllovaki ka qenë një storie e suksesit. Modeli APA është i bazuar në logjikë Byrokratike, Ëeberiane, ky shërbyesit individual Civil janë përgjegjës për hapat specific në vlerësimin e dokumenteve dhe të vendimeve përfundimtare apo finale që mirren duke u bazuar në grumbullimin e të gjitha vlerësimeve në bazë të formulave

<sup>8</sup> Miroslav Bebavy "Rast studimorë: Agjencioni Bujqësorë për Pagesa, Slovakia" i publikuar nga Instytut Spraë Publicznych, pg.2.

<sup>9</sup> Ibid pg.3-4

<sup>10</sup> Ibid pg.4

<sup>11</sup> Ibid pg.5

<sup>12</sup> Mbështetje për pregaditjen e IPARD (Termet Specifike të Referencave). Një Projekt i Financuar nga BE i menaxhuar nga AER në FYROM pg. 1.

<sup>13</sup> Ibid pg. 2.

<sup>14</sup> Ligji për bujqësi dhe zhvillim rural i Republikës së Shqipërisë. Për informata të mëtejme vizitoni <http://ëëë.mbumk.gov.al/pdf/720.pdf> vizituar për herë të fundit me 07.07.2008.

<sup>15</sup> Agjencioni Kosovarë për Mbështetje Rurale dhe Tregje Bujqësore?

<sup>16</sup> Përderisa modeli Slloven është mjaft i mirë, Modeli i Qipros është më i përshtatshëm dhe më i mirë për Kosovën sesa Modeli Sllovak, për shkak të faktorëve siç është niveli i zhvillimit bujqësorë, dhe madhësia mesatare e fermës dhe struktura: (në Sllovaki, kjo është më e madhe sesa në Kosovë). Edhe pse ende nuk është plotësisht

operacionale, zhvillimi i ANP Kroat është me interes për Kosovën, duke pasur parasysh se Kroacia është një vend Kandidat.

Është një parakusht për vendet që dëshirojnë të hyjnë në BE se ato duhet që të themelojnë një Agjencion të Pagesave. Kapitulli 11 (I Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të agjendës së negociatave në mes të BE –së dhe të Vendit që synon që të bashkohet në BE), mbulon rregullat e lidhura, shumica e të cilave janë të aplikueshme në mënyrë direkte. Aplikimi i duhur i këtyre rregullave dhe zbatimi i tyre efektiv dhe kontrolli nga një administrim efikas public janë të domosdoshme për funksionimin e PPB –së.

Udhëheqja e PPB –së kërkon themelimin e sistemeve menaxhuese dhe kualitative siq është Agjencioni Nacional i Pagesave dhe Administrimi i Integruar dhe sistemet e kontrollit (IACS), si dhe kapacitetin për të implementuar masat e zhvillimit Rural. Shtetet Anëtare duhet që të jenë në gjendje të aplikojnë legjislacionin e BE –së në mbështetje direkte të Fermave, dhe të implementojnë organizatat e përbashkëta tregëtare për produkte të ndryshme bujqësore 2.

Kosova si një Shtet i Ardhëshëm Potencial i BE –së duhet që të adaptojë dhe të implementojë *acquis communautaire* siq është mbuluar në 35 Kapitujt e negociatave me BE –në. Bazuar në këtë, themelimi i Agjencionit Nacional për Pagesa nga Qeveria e Kosovës është një Obligim sipas Kapitullit 11 i.e. a *sine qua non*3.

#### **4. Karakteristikat e Perbashkëta të ANP që kanë ndodhur pas Themelimit në Vendet e tjera**

Disa karakteristika të ANP të themeluara rishtazi në SHRA janë siq vijojnë:

- ANP –të janë themeluar shumë vite përpara se vendet të jenë bashkuar në BE (p.sh. në Poloni në 1994, në Lituanin në 1999, në Slloveni në 1999, në Latvi në 2000, në Republikën Çeke (është riorganizuar), në Gusht 2000, në Qipro në 2003, dhe në Republikën Sllovaqe në 2003);
- ANP janë Institucione Buxhetore;
- Në të gjitha ANP të krijuara së fundi, objektiva kryesore për themelimin e këtyre agjencioneve ka qenë për të përfituar nga fondet e SAPARD;
- Themelimi është bazuar në legjislacionin e aprovuar nga Qeveria paraprakisht;
- Agjencionet zakonisht janë në përgjegjësi të Ministrisë së Bujqësisë, dhe janë nën mbikqyrje të Ministrisë së Financave mbrenda fushës së menaxhimit të fondeve publike. Ka raste, siq është Qipro, ku një ANP është i themeluar dhe operon si një organizatë publike autonome, që do të thotë se është një entitet i pamvarur ligjorë që nuk bie nën mbikqyrje të asnjë Ministrie ose Departamenti të Qeverisë;
- ANP –të janë trupa të Akredituara;
- Detyrat Kryesore të ANP –ve kanë qenë të implementojnë politikën strukturore bujqësore dhe masat politike të Zhvillimit Rural;
- Ato kanë themeluar dhe kanë implementuar IACS;
- ANP –të kanë implementuar masat politike të qmimeve të tregjeve bujqësore, kanë themeluar/implementuar një sistem të informimit të tregjeve (MIS), mbledhjen e të dhënave për sistemet informuese të tregjeve në nën sektorët e qumështit, mishit, vezëve, ripërtpësve të vegjël dhe të perimeve;
- Kanë kryer kontrolla të mbrendshme dhe auditime të mbrendshme.

## **5. Agjencionet e Pagesave në VEL dhe të Vendeve Kandidate**

Është e domosdoshme për secilin vend kandidat për të themeluar një Agjencion për Pagesa me qëllim që të pranimit të ndihmës para – qasëse. Vendet e Ballkanit Perëndimorë do të pranojnë mbështetje nën Programin IPARD.

Teksti vijues përmbledhë përvojën e themelimit të Agjencionit të Pagesave në dy VEL, një Vend kandidat dhe një vend jo – kandidat.

### **5.1. Sllovenia**

Agjencioni Slloven për Tregjet Bujqësore dhe për Zhvillimin Rural (AAMRD) është një trup mbrenda Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe të Ushqimit. Është një Agjencion i Pagesave i Akredituar nën Legjislacionin Evropian dhe Nacional. AAMRD është themeluar për të implementuar programet e reformave politike bujqësore, të adaptohen në Politikën e Përbashkët Bujqësore të BE –së, dhe të shpërndajë ndihmën para – qasëse të SAPARD. Agjencioni është një nga Institucionet Kyqe për të siguruar fondet Evropiane dhe Nacionale për Ruajtjen/Zhvillimin e zonave rurale Sllovene dhe për përforcimin e tregjeve Bujqësore. Prej 1 Majit të 2004, Agjencioni ka menaxhuar/shpërndarë fondet Evropiane nga Sekcioni i Garantuar i Udhëzuesit për Bujqësinë Evropiane dhe Fondit të Garantuar.

Agjencioni kryen detyrat e ndërlidhura me implementimin e masave në Bujqësi, pylltari, artikuj ushqimorë dhe peshkatari në pajtim me politikën nacionale dhe me PPB. Me 1 Maj 2004, Agjencioni ka kompletuar implementimin e programit SAPARD dhe ka filluar implementimin e masave të reja (Të dokumentit të Vetëm Programues 2004-2006; Të programit për Zhvillim Rural 2004-2006; të masave tregtare – duke lëshuar lejet e importit dhe të eksportit, menaxhimin e deponimeve siguroese, pagimin e këthimeve nga eksporti). Agjencioni implementon përafërsisht 100 masa të akredituara, kryesisht në laminë e pagesave direkte. I kryen pagesat për zonat tokësore dhe numrin e kafshëve, pagesat për zonat më pak të favorizuara, dhe masat agro – mjedisore, gjatë kooperimit për të mbijetuar pasojat e fatkeqsive natyrore për Bujqësi. AAMRD punëson më shumë se 270 persona. Përafërsisht 80% e punëtorëve të tyre kanë së paku edukim univerzitarë, kryesisht në ekonomi dhe në Bujqësi.<sup>5</sup>

Detyrat kryhen në Tregjet Bujqësore, Zhvillimin Rural dhe Sekcionin e Pagesave Direkte, dhe në aferat Financiare, të Kontrollit, Aferave të Përgjithshme, Menaxhimit të Informimit dhe të Teknologjisë, dhe Shërbimet e Mbrendëshme të Auditimit. Agjencioni është duke implementuar Programin për Zhvillim Rural 2007-13.<sup>6</sup>

### **5.2. Sllovakia**

Agjencioni për Pagesa Bujqësore i Sllovakisë (APA) është krijuar në 2003 nga një ligj special (473/2003 Z.z.)<sup>7</sup>, 8. Është një Organizatë Buxhetore që do të thotë se Buxheti i sajë është plotësisht i Integruar në atë të Ministrisë së Bujqësisë. APA Ka Qendrën në Bratisllavë dhe 18 degë Regjionale. Detyra e sajë është që të dorëzojë aktivitetet administrative të ndërlidhura me mbështetje financiare nga resurset e BE –së dhe nga resurset nacionale në Bujqësi, Pylltari dhe Peshkatari.

Detyrat themelore të APA janë menaxhimi i aplikacioneve për fondet nacionale të BE –së për Bujqësi dhe për Zhvillim Rural, dhe menaxhim Financiarë të Projekteve / Pagesave të aprovuara 9.

APA ka 5 Sekcione Kryesore Organizative: mbështetje të orientuar në projekt; mbështetje direkte; organizimi i tregut; pagesat; dhe kontrolli.

Në fund të 2005, APA ka pasur 595 vende pune dhe 560 punëtorë mesatarisht 2005.10

Sipas Bebavy11, Agjencioni për Pagesa i Sllovakisë ka qenë i suksesëshëm sipas matjes së gurthemeleve ose shpërndarjeve kyçe të pagesave për pranuesit, dhe legjitimiteti/rregullsia në atë se Agjencioni e përcjellë legjislacionin nacional të BE –së dhe ka sistemet financiare të kontrollit që plotësisht pajtohen me kërkesat e BE –së.

### **5.3. Maqedonia**

Fondet e IPA nën komponentën e zhvillimit rural (#5) janë të emërtuara si IPARD (Instrumenti i para – qasjes që mbështetë Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural). Këto do të shpenzohen nën mbikqyrjen e Programit IPARD që është pregaditur nga Qeveria e Ish Republikës Federale të Jugosllavisë, Maqedonisë, e adaptuar nga vendimi i Komisionit KE/2006 me 25 Shkurt 2008.12

Në Maqedoni, Agjencioni ipër Pagesa është quajtur Agjencioni për Mbështetje Financiare dhe Zhvillim Rural. Roli i sajë është që të implementojë Programin IPARD. Funkzionet e Agjencionit IPARD mvaren nga Akreditimi Nacional nga Zyrtari për Akreditim Nacional (ZAN) mbrenda Ministrisë së Financave 13

### **5.4. Shqipëria**

Në Shqipëri, Agjencioni për Pagesa është themeluar me Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Sipas Nenit 21, Agjencioni është një trup public i financuar nga buxheti shtetërorë. Ka statusin e etnitetit Ligjorë dhe mvaret nga Ministri. 14 Në Shqipëri Agjencioni është përgjegjës për:

- Implementimin e masave politike për bujqësi dhe zhvillim rural;
- Elaborimin e raporteve dhe të analizave të ndërlidhura me zhvillimin bujqësorë;
- Themelimin dhe funksionimin e menaxhimit të integruar dhe të sistemeve kontrolluese;
- Themelimin dhe implementimin e sistemeve të informimit të tregjeve;
- Zhvillimi dhe Mirëmbajtja e Bazës së duhur të të dhënave;
- Implementimin e masave kontrolluese dhe të auditimit të mbrendëshëm; dhe
- Inspektimin e fermerëve dhe të përfituesve të tjerë që kanë përfituar nga fondet e programit për bujqësi dhe zhvillim rural.

## **6. Organizimi i Mbrendëshëm i Agjencionit Nacional të Pagesave në disa vende**

ANP zakonisht është e organizuar në tri nivele: Zyret kryesore në Kryeqytet, zyret regjionale (të vendosura në qytetet kryesore regjionale), dhe zyret komunale (të

vendosura në të gjitha komunat). Struktura e mbrendëshme e ANP ndryshon nga njëri shtet në tjetrin mvarësisht nga madhësia e atij shteti dhe nga fondet buxhetore që duhet të alokohen për përfituesit në fjalë, e gjithashtu edhe të lamisë të punës së tijë.

ANP zakonisht udhëhiqet nga një Drejtor i zgjedhur nga Qeveria sipas propozimit të Ministrit të Bujqësisë. Në Qipro, ANP kryesohet nga Komisioneri për pagesa Bujqësore që është i përzgjedhur nga Këshilli i Ministrave.

Organizimi i mbrendëshëm i ANP në vende të ndryshme është përmbledhur më poshtë.

### **6.1. Slovenia**

Implementimi i Masave në ANP e Sllovenisë është i organizuar në tri njësi të mbrendëshme organizative: Sekcioni i pagesave direkte, Sekcioni i Zhvillimit Rural dhe Sekcioni për Tregjet Bujqësore.

### **6.2. Latvia**

Ekzistojnë shtatë Departamente që operojnë në Zyrën kryesore të Agjencionit: Departamenti Administrativ, Departamenti i Auditimit, Departamenti i Kontrollit, Departamenti i Pagesave Direkte nga BE, Departamenti i Financave, Departamenti i Informimit dhe Departamenti për Mbështetje.

### **6.3. Republika Qeke**

ANP është e organizuar në njësi / departamente përgjegjëse për ofrimin e mbështetjes për IACS, Komoditetet Bujqësore dhe Shkëmbimin Ndërkombëtarë. Gjithashtu ekziston Departamenti Ligjorë dhe një Departament i Auditimit të Mbrendëshëm. Agjencioni është i mbikqyrur nga një Bord Mbikqyrës I përbërë prej 5 Anëtarëve, secili anëtarë i të cilës është anëtarë i Parlamentit.

### **6.4. Polonia**

Struktura Organizative e ANP përbëhet nga tri nivele: Qendra Kryesore, 16 Zyre Regjionale në qytetet kryesore, dhe 314 Zyre Lokale të vendosura në Komuna.

### **6.5. Estonia**

ANP është e organizuar në dy nivele: Zyra kryesore dhe Zyret Regjionale në të gjitha 15 zonat.

### **6.6. Lituania**

ANP është e organizuar në 9 Departamente: Financa dhe Llogarimbajtje, Auditimi i Mbrendëshëm, Vlerësimi i Rrezikut, Programet për Zhvillim Rural, Shkëmbimi i Jashtëm, Teknologjia Informative. Kontrolli, aferat e përbashkëta dhe Ligjore. Gjithashtu ekziston edhe Njësiti I menaxhimit të Projekteve dhe të Raporteve të Aktiviteteve dhe Njësiti për Marrëdhënie me Publik. Agjencioni Udhëhiqet nga Drejtori dhe dy Zëvendës Drejtor.

### **6.7. Qipro**

ANP në Qipro është e organizuar në 7 divizione: Shërbimet Teknike, Autorizimi i

Pagesave, Ekzekutimi i Pagesave, Llogarimbajtja, TI, Administrimi dhe Resurset Njerëzore, dhe Trupat e Deleguar. Mbrenda Strukturës së Brendëshmetë ANP ekziston shërbimi për Auditim, Shërbimi kundër mashtrimeve dhe shërbimi për kontrollimin e Kualitetit, e gjithashtu edhe një njësi për Lidhjet Nacionale & Ndërkombëtare dhe Pajtueshmëri & Shërbime Akredituese. ANP udhëhiqet nga një Komisioner dhe nga një Asisten Komisioneri. ANP ka një zyrë qendrore dhe gjashtë zyre regionale.

## **7. Sistemet e Kontrollimit të Menaxhimit**

Sistemet e Kontrollimit të Menaxhimit për ANP janë të themeluara mirë, dhe kanë kaluar nëpër përvojat dhe praktikat e 15 Shteteve Anëtare të BE –së. Sistemet e Kontrollimit të Menaxhimit janë të dizajnuara që të përmbushin aspektet shumë – dimensionale të veprimtarive të ANP. Planifikimi i Duhur dhe kontrolli për të siguruar një paraqitje të mirë të ANP arrihet përgjatë Auditimeve të rregullta të mbrendëshme, Kontrollave të Mbrendëshme dhe Auditimeve të Jashtme, dhe përdorimi i duhur i Fondeve të dedikuara për përfituesit. Kontrollat për menaxhimin e rrezikut dhe për sisteme të tjera janë të ndërlidhura me institucione të tjera qeveritare dhe të BE –së. Qëllimi i sistemeve të kontrollit të menaxhimit është që të ofrojnë menaxherët dhe stafin tjetër menaxhues të ANP me një kuptim se sit ë mbahen organizatat nën kontrollë, ( me një funksion të operimit në bazë të etikave të mira).

Akreditimi i ANP kryhet nga KE duke adaptuar një vendim që konfirmon se ANP mund që në mënyrë të lirë të menaxhojë dhe të shpërndajë fondet mbështetëse të BE –së për përfituesit përfundimtarë. Megjithatë, akreditimi është një proces i gjatë, dhe mvaret nga niveli i zhvillimit të atij Vendi.

ANP është e menaxhuar nga Drejtorët Gjeneral/Zyrtari Ekzekutiv që zakonisht zgjidhet nga Qeveria sipas kërkesës së Ministrit të Bujqësisë. Sa i përket sistemeve të kontrollit të menaxhimit, ekzistojnë raste ku ANP është e mbikqyrur nga një Bord Mbikqyrës (p.sh. në Republikën Qeke). Në rastet e tjera, masat politike Bujqësore kryhen nga Ministria e Bujqësisë me fonde publike të menaxhuara nga Ministria e Financave.

## **8. Një Model i Agjencionit të Pagesave për Kosovën**

Agjencionet e Pagesave ndryshojnë sa i përket emërimit dhe strukturës, mvarësisht nga kultura e tyre ligjore dhe administrative. Në Shqipëri, quhet Agjencion i Pagesave: në Maqedoni, është Agjencioni për Pagesa për mbështetje Financiare dhe Zhvillim Rural; në Slloveni, është Agjencioni për Tregjet Bujqësore dhe Zhvillim Rural; dhe në Sllovakia, është Agjencioni i Pagesave Bujqësore. Megjithatë, emir dhe struktura e Agjencionit nuk është e rëndësishme. Për të qenë e suksesëshme një Agjencion i Pagesave mvaret nga një mori e ligjeve të aplikuara p.sh. Ligji mbi Prokurimin Publik; Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; dhe Ligji për Shërbimin Civil etj.

Kosova së shpejti duhet që të transpozojë në legjislacionin nacional Rregulloret e BE – së sa i përket ndihmës së dhënë Shteteve Kandidate. Kjo përfshinë: Rregulloren e Këshillit Nr. 1164/94/EC që vendosë fondet kohesuese; Rregullorja e Këshillit Nr. 1267/1999/EC që themelon një Instrument për Politikat Strukturore për Para – Qasje; dhe Rregulloren e Këshillit Nr. 1260/1999/EC që vendosë masat e përgjithëshme për

Fondet Strukturore.

Themelimi i ANP në Kosovë mund që të zhvillohet në dy Faza:

1. Themeloni një Organizatë / Trup që do të përdorë / shpërndajë resurset financiare nga BKK; dhe
2. Transformojë këtë trup në një ANP funksionale deri në kohën kur Kosova të jetë vend Kandidat.

Agjencioni duhet që të ketë 7 Zyre Regjionale në Prishtinë, Prizren, Mitrovica, Gjilani, Peja, Gjakova dhe Ferizaj, me qëllim të përshejtit të alokimit të fondeve dhe të ekzekutimit të pagesave.

Themelimi i Agjencionit të Pagesave në Kosovë bllokohet për shkak se financat për shpenzimet publike janë të limituara. Si e tillë, ANP duhet që të ketë strukturë që duhet të zhvillohet hap pas hapi sipas prioriteteve të qarta dhe resurseve të gatshme. Departamentet e Administrimit dhe të Prokurimit Publik janë të domosdoshme pasi që Agjencioni do të jetë një Organizatë Buxhetore që duhet të ketë menaxhimin vetanë të resurseve njerëzore. Departamentet e domosdoshme duhet që të krijohen duke pasur parasysh modelet e vendeve të tjera. Agjencioni i Pagesave në Kosovë duhet që të masë suksesin e sajë duke u bazuar në dy fazat kyqe: shpërndarjen dhe legjimitetin/ rregullimin, (siq është diskutuar më lartë).

## 9. Konkludim

Agjencioni i Pagesave 15 është një domosdoshmëri për Kosovën, dhe duhet që të themelohet sa më shpejtë që të jetë e mundur, me qëllim të përgaditjes për të përfituar nga Programi IPARD. Kosova duhet që të adaptojë një kornizë të përparuar dhe të detalizuar për të siguruar përdorim të duhur të fondeve dhe të menaxhimit të mirë financiarë. Modelet e ANP të Sllovenisë, Qipros dhe Kroacisë ofrojnë shembuj të mirë për Kosovën për të pasuar 16.

Suksesi i Agjencionit të Pagesave kushtëzohet nga Implementimi i duhur i Ligjeve vijuese: Ligji për Auditim; Ligji për Prokurimin Publik; Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi; Ligji për Shërbimin Civil, dhe transpozimi i *acquis communautaire* relevant në legjislacionin nacional etj.

Kosova ka nevojë vetëm për një agjencion të akredituar me 7 zyre regjionale që do të lehtësojnë procedurat administrative për përfituesit. Megjithatë, duhet që të ketë vetëm një, qendër vendim – marrëse për të shmangur korrupsionin dhe konfliktin e interesave, e gjithashtu të sigurojë efikasitet.

## 10. Orari

Plani për të themeluar një ANP në Kosovë do të kërkojë diskutime mbrenda MBPZHR, me të gjitha palët me interes dhe institucione të tjera qeveritare, e gjithashtu të KE, organizata të mbrendëshme dhe donatorë të tjerë, bazuar në orarin e mundur vijues:

- Procesi për Restrukturim/Riorganizim të mbrendëshëm i MBPZHR –së I Finalizuar (Shtatorë 2008).

- Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural i Adaptuar dhe i Dekretuar nga Kuvendi (Fundi i Marsit 2009);
- Rregullimi Ministrorë për të themeluar pasardhësit e ANP –së (Prill 2009);
- Vendimet Qeveritare për të themeluar pasardhësit e ANP (Maj 2009);
- Përfshirja e kërkesës buxhetore për pas ardhësin e ANP për buxhetin e propozuar të MBPZHR –së për 2010 (Qershorë 2009);
- Të Draftojë dhe të Adaptojë akte të tjera dhe Udhëzime Administrative mbrenda MBPZHR –së (Qershorë – Shtatorë 2009);
- Vendimi i Qeverisë për të zgjedhur Drejtorin e Pasardhësit të ANP –së (Tetorë 2009);
- Pasardhësi i ANP të jetë FunkSIONAL apo operACIONAL (1 Janarë 2010) dhe;
- Themelimi i një ANP plotësisht funksionale (Një muaj përpara se të behet vend kandidat).